

INFORMACIONE PËR REGJISTRIMIN NË SHËRBIMIN PARASHKOLLOR 0-3 VJEÇ

VITI SHKOLLOR 2017 - 2018

KUSH MUND TË REGJISTROHET

Aplikimet *online* për vitin shkollor 2017-2018 në Shërbimet Edukuese 0-3 vjeç (çerdhe dhe hapësira lojrash), janë të rezervuar fillimisht fëmijëve të lindur nga 01.01.2015 deri më 31.05.2017, dhe do të nisnin nga fundi i marsit deri në fillim të prillit, e pas një periudhe ndërprerjeje, do të rifillojnë nga mesi i dytë i muajit maj deri në fillim të qershorit por vetëm për fashën e të vegjëlve. Familjet e fëmijëve të lindur nga 01.06.2017 deri më 31.08.2017, mund të prezantojnë kërkesën nga muaji shtator, edhe pse jashtë afatit të aplikimeve por me kusht që fëmija të ketë mbushur tre muaj.

Mund të regjistrohen fëmijët të cilët kanë të paktën një prej prindërve rezident në Komunën e Firences. Në rastin e prindërve të ndarë/ divorcuar, kërkesën për aplikimin *on line* e bën prindi me të cilin është rezident fëmija por me kusht që autorizimi i prindit tjetër të jetë i bashkangjitur me kërkesën. Në rast mungese të autorizimit, kërkesa për aplikim nuk mund të kryhet.

SI MUND TË REGJISTROHENI

Kërkesa për regjistrim mund të bëhet vetëm *on line* duke u lidhur me faqen e Shërbimit të Komunës së Firences "[Iscrizione nidi d'infanzia/spazi gioco educativo](#)" e cila ka formën e vetëdeklarimit dhe të deklaratës zëvendësuese të vërtetimit.

Për aplikim **është i nevojshëm, në alternativë, të keni një nga dokumentet e mëposhtëm** (të cilat ju mund ti gjeni me kohë):

A) Kredencialet (emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi): kush nuk i ka marrë mund ti kërkojë (me një dokument të vlefshëm dhe kodin fiskal) pranë zyrave të Marrëdhënies me Publikun (URP) të Komunës së Firences, zyrave të Shërbimeve për parashkollorët- Çerdhet, Rruga Nicolodi n.2 ose, vetëm për familjet e huaja, pranë Zyrës së Emigracionit, Lagjia 5- Villa Pallini, Rruga Baracca 150 p;

Gjithashtu, ju mund të regjistroheni në faqen e internetit për të kërkuar kredencialet duke plotësuar formularin online: <http://centroservizi.lineacomune.it/ConsoleCittadino/>.

Më pas duhet të paraqiteni pranë zyrave të akredituara sëbashku me një dokument të vlefshëm dhe kodin fiskal për të tërhequr këto kredenciale (një zarf të mbyllur me passwordin brënda):

http://politichesocioabitative.comune.fi.it/stranieri/servizi/sportelli_immigrazione.html

B) Karta e shëndetësisë e qarkut e aktivizuar pranë sporteleve ASL të Rajonit Toscana, ose **Karta Kombtare e Shërbimeve (CNS)**.

Në këto raste, nëse dëshironi të lidheni me Shërbimin *on line* nga PC-a personal duhet të keni një *lexues smart card* i cili mund të blihet në Zyrat Shëndetësore.

VINI RE për Shërbimet *on line* duhet të përdorni vetëm **browser Mozilla Firefox ose Chrome**.

Familjet e huaja që janë rezidentë në Firencë, dhe kanë vështirësi me gjuhën italiane, mund të shkojnë pranë Zyrës së Emigracionit, Lagjia 5- Villa Pallini, Rruga Baracca 150 p, ku ndërmjetësit gjuhësor-kulturor do ti ofrojnë ndihmën e nevojshme për plotësimin e aplikimit *on line*. Mund të lenë një takim duke kontaktuar Zyrën e Emigracionit (email: immigr@comune.fi.it – tel.: 0552767078).

http://centroservizi.lineacomune.it/ssproxy/comune_di_firenze/politiche_sociali/immigrazione/sportello_unico_comunale_immigrazione/sportello_immigrazione.html

Pas mbylljes së regjistrimeve do të formohet dhe publikohet lista e pranimeve në bazë të pikëve të marra sipas kriterëve të cilat do të publikohen *on line* para hapjes së regjistrimeve.

SA PAGUHET

Tarifat ndryshojnë në varësi të orarit të frekuencimit të përzgjedhur dhe të të ardhurave familjare nëse është prezantuar kërkesa për lehtësim tarifash *on line*.

Gjithashtu, në faqen e internetit Portale Educazione të Komunës është një simulues tarifor “simulatore di tariffa” që ndihmon familjet për të patur një ide përsa i përket shifrës që duhet të paguajë.

DUHET TË KEM NË MËNYRË TË DOMOSDOSHME ÇERTIFIKATËN E ISEE-së ?

E patura e çertifikatës ISEE nuk është e domosdoshme për aplikimin *on line*. Megjithatë, kjo çertifikatë është e rëndësishme për arsyet në vijim:

1) Kush ka çertifikatën e ISEE-së me vlerë më të ulët se € 32,500.00 mund të prezantojë, në momentin e aplikimit *on line*, edhe kërkesën për lehtësim tarifash.

Kërkesa për lehtësim tarifash mund të prezantohet sipas mënyrave të mëposhtme:

- në momentin e **aplikimit për regjistrim** në Çerdhe /Hapësirë lojrash
- pranë **qëndrave CAAF të lidhur me marrëveshje** dhe të aktivizuar me Shërbimin *On Line* të Komunës së Firences
- nëpërmjet **Shërbimit *On Line* të Komunës së Firences** në zërin- “Domanda unica di Agevolazione tariffaria Servizi di Supporto alla Scuola/Asili Nido/Centri estivi”

2) Çertifikata ISEE-së më e ulët se € 42,000.00 lejon të përfitonit pikë shtuese në renditje të listës

3) Çertifikata ISEE-së me vlerë mbi € 42,000.00 vlen gjithsesi si kriter preference në rast të pikëve të barabarta

4) Për të gjithë ato që janë në listat e pritjes (sepse nuk janë pranuar në çerdhe apo hapësira lojrash) mund të jepen kontribute ekonomike për regjistrimet në strukturat private të akredituara.

Për të përfitur nga këto kontribute do të jëtë e detyrueshme që të tregohet vlera e ISEE-së sipas mënyrës dhe kohës që do të publikohet më vonë në njoftimin e kontributit ekonomik.

CILAT DHE SA STRUKTURA MUND TË ZGJIDHEN?

Mund të zgjidhen deri më 5 struktura sipas një renditje përparësie. Disa struktura pranojnë vetëm fëmijë me moshë të mesme dhe të madhe ose vetëm të madhe; për këtë arsye, do të jëtë e mundur të zgjidhni vetëm

ato struktura që janë të përshtatshme me moshën e fëmijës. Për çdo strukturë, aplikuesi duhet të vendosë për **orarin e daljes dhe të hyrjes**, sipas atyre të prashikuara nga struktura arsimore.

Theksojmë se, në rast pranimi, **orari i daljes së përzgjedhur mbetet i njëjti për gjithë vitin shkollor**. Pas fillimit të frekuentimit mund të vlerësohen ndryshime në orar, gjithnjë të justifikuara siç duhet, dhe vetëm pas muajit dhjetor.

Me hapjen e regjistrimeve, do të caktohen dhe ditët kur familjet mund të vizitojnë strukturat arsimore.

Lista e plotë e shërbimeve 0-3 vjeç:

http://educazione.comune.fi.it/export/sites/educazione/materiali/0-3/elenco_servizi14.pdf

Lista e shërbimeve komunalë të ndara sipas lagjeve:

http://educazione.comune.fi.it/0-3anni/sistema_servizi/servizi_comunali.html

Strukturat private të akredituara:

http://educazione.comune.fi.it/0-3anni/sistema_servizi/servizi_accreditati_authorized.html

Karta e shërbimeve:

http://educazione.comune.fi.it/0-3anni/sistema_servizi/carta_servizi.html